



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



NTSH "Elektra"  
Rr. Adem Jashari  
Hani i Elezit

Vendimi LIC/CO-CIMC: 2008/10  
Ref: 0805/0718/CIMC/II

## VENDIM

*lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllorë NTSH "Elektra"- Hani i Elezit*

---

### Fakte

1. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), duke vepruar në bazë të Nenit 2.5 dhe Nenit 11 të Ligjit për KPM-në Nr. 02/L-15 ka nxjerr Rregulloren e Distribimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC 2007/04) e cila ka hyrë në fuqi më datë 06 korrik 2007.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktiv kabllor kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Operatori kabllor NTSH "Elektra", si operatorë kabllorë aktiv i cili operon në Hani të Elezit ka aplikuar për licencë të KPM-së për operator kabllor më 15 prill 2008.

### Arsyetim

4. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor NTSH "Elektra" ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.

5. Me Rregulloren për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor, prandaj Këshilli i KPM-së vlerëson se një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.
6. Operatori kabllorë NTSH “Elektra” do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
7. Nëse pas marrjes së licencës, operatori kabllor NTSH “Elektra” siguron marrëveshje shtesë/të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllor, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve për të cilat e ka licencuar. Operatori kabllor NTSH “Elektra” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t’i ketë siguruar ato.
8. KPM vlerëson se NTSH “Elektra” ka paraqitur aplikacionin brenda afatit të përcaktuar nga ana e Këshillit të KPM-së në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04.
9. Prandaj, KPM vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor NTSH “Elektra” ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

### Vendim

10. KPM konkludon se NTSH “Elektra” ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kablore përmes sistemit kabllor në Han të Elezit.
11. KPM vendos që operatorit kabllor NTSH “Elektra”, i cili operon në Han të Elezit, t’i lëshoj licencën e KPM-së për të ofruar përmes sistemit kabllor shërbime të programeve kablore për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
12. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor NTSH “Elektra” do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
13. Në pajtueshmëri me Nenin 10 të Rregullores CIMC Nr. 2007/4, çdo operator kabllor duhet të paguajë taksën vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencim të Operatorëve Kabllorë është i përcaktuar me Nenin 3.1 të Vendimit për Nivelin, Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Takës për Licencim të Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve përmes Kabllos (CIMC 2007/05).

14. Në pajtueshmëri me Nenin 6.2 të Vendimit (CIMC 2007/05), operatori kabllor NTSH "Elektra" duhet ta paguaj taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të Licencës.

### Lëshimi i Vendimit

15. Këtë vendim e lëshon Këshilli i KPM-së.


A. Guri  
Argjentina Grazhdani  
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.

29/05/08  
datë

### Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

N. Krasniqi  
Naife Selimaj Krasniqi  
Shefe Ekzekutive



29.05.08  
datë